

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KRU"BIFURKACIONI"SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **600-KRU"BIFURKACIONI"SH.A.-24-12288-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me klor dioksid**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	SAMET MESTANI B.I.
NUI	810589674
Adresa	Prizren, Nr.37, Pejës
Vendi	Prizren
Kodi postar	20000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Samet Mestani
Adresa elektronike	samet.mestani@hotmail.de
Data e parashtrimit të ankesës	26.12.2024

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me klor dioksid

Emërtimi: Furnizim me klor dioksid

Kodi/Numri: 2024/600-KRU"BIFURKACIONI"SH.A.-24-12288-1-2-1/B05-0030982

Njoftimi për kontratë: 28.11.2024

Hapja e ofertave: 09.12.2024

Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 16.12.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim të vendimit: 21.12.2024

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim: 23.12.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), Nenet si në vijim:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me date 09.12.2024 kemi dorëzuar ofertën për këtë aktivitet të prokurimit, konform të gjitha kushteve dhe kriterëve të dosjes së tenderit.

Me 16.12.2024 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesit e eliminuar dhe Njoftim mbi Vendimin e AK për rekomandim me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik AG Petroleum SH.P.K. ; EOX BALKAN SH.P.K. Anton Çeta p.n. Kaçanik i Vjeter, 71000, Kaçanik.

Na është lejuar qasja në dokumentacionin zyrtar me kohë, dhe pas shqyrtimit të Ofertës të OE të rekomanduar për kontratë, në bazë të dokumentacionit duke krahasuar me kërkesat si në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë kemi konstatuar se Komisioni Vlerësues kundërligjshëm ka rekomanduar për fitues një OE të papërgjegjshëm me këto shkelje:

Pretendimi nr.1:

Perdorimi i standardeve të dyfishta. Sipas FDT-së Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale "Kapaciteti teknik dhe profesional" kriteri: Kërkesa 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme gjatë 3 (tre) viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë, në vlerë prej jo më pak se 30,000.00 Euro. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 1.Një listë e kontratave, e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik (origjinal), me të cilën saktësohen të gjitha furnizimet e përfunduara gjatë 3 (tre) viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit si dhe emrin e institucionit apo kompanisë private për të cilat i keni kryer këto furnizime. Listës duhet ti bashkëngjitet kur furnizimi është kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen referencat apo procesverbalet e pranimeve teknike të lëshuar nga autoriteti i tillë, kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka. Referencat apo procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e përfunduara duhet të përputhën me

kontratat e prezantuara në listë.

Gjetjet: Ju si AK keni bërë kërkesë për Sqarim ndaj Kompanisë sonë në lidhje me dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme gjatë 3 (tre) viteve të fundit jo më pak se 30,000.00 Euro, dhe e keni REFUZUAR sqarimin tonë me arsyetimin se: Në listën e prezantuar, konkretisht kontrata Nr.1, "Furnizim me Sequion 40 N32" për autoritetin kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, nuk keni prezantuar Referencë apo Procesverbal të pranimit teknik të lëshuar nga autoriteti, ndërsa ne e kemi prezantuar Faturën dhe Fletpagesën Bankare. Ju sqaroj se Kontrata me KEK është Kornizë dhe është në realizim. Ju si AK të njëjtin Kërkesë për sqarim e keni bërë edhe ndaj OE të propozuar për kontratë, derisa OE i propozuar për Kontratë ka Vërtetuar se dëshmon vetëm një Referencë me vlerë 10,800.00 Euro ndërsa Referencën me vlerë 14,500.00 është Kontratë Kornizë që përfundon me datë 08.03.2025 dhe është ende aktive. Gjithashtu 2 Referencat tjera (Royal Beverage L.L.C. dhe MR Mirembajtja SH.P.K.) janë kontrata kornizë e që janë ende në realizim. Ju si AK me këtë veprim keni përdorur Standarde të Dyfishta ndaj Kompanisë Sonë duke e refuzuar Referencën tonë dhe duke pranuar Referencat e OE të propozuar për kontratë.

Pretendimi nr.2:

Konform RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar), Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik, Pika 26.15 Kurdo që Operatorët Ekonomik marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomik së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP. Njoftimi për Kontratë është me datë 28.11.2024, ndërsa Forma Standarde e Marrëveshjes të Hartuar dhe Miratuar nga KRPP është vendosur në Sisteminin eprokurimi „MARRËVESHJE DEKLARATE per formimin e grupit 2024“ dhe miratuar me datë 11.11.2024. OE të propozuar për kontratë në dosjen e tenderit ka prezantuar MARREVESHJE BASHKEPUNIMI – KONSORCIUM të formës jo-standarde të miratuar nga KRPP.

Pretendimi nr.3:

GOE të rekomanduar për kontratë, nuk kanë dorëzua asnjë Specifikacion të Produkteve, Komponentes A dhe B ashtu si është kërkuar në dosjen e tenderit. Ka dorëzuar vetëm dy certifikata të Analizës të cilat nuk janë në rregull sepse ju mungojnë parametrat të kërkuar në specifikacionet teknike si në dosjen e tenderit siç janë: vlera e pH-se tek Komponenta A dhe dendësia. Komponenta A nuk ka mundësi të ketë peshën specifike 1,64 g/cm³ dhe dendesi 1,20 g/cm³ (Dendesia dhe pesha specifike janë i njëjti parameter). Nuk ka ofruar dokument që këto dy komponente janë të lejuara për dezinfektimin e ujit të pijes sipas Standardeve EN. Fletat e sigurisë edhe ashtu janë të pavlefshme sepse ka kohë që janë ndryshuar sipas ligjeve për substancat kimike dhe janë të pa përdorshme. Fletat e sigurisë asnjehere nuk e zëvendsojnë specifikacioni e kualitetit të produkteve dhe si të tilla nuk duhet të përdoren ose të merren parasysh. Fletat e sigurisë janë të përdorshme vetëm për

sigurinë e përdoruesve për që të kenë njohuri si të mbrohen nga helmimi i dioksidit të klorit, për ruajtje të ambientit si ajrin ashtu edhe ujin si dhe mikroorganizmet nëse rastësisht rrjedh në kanalizim. Dioksidi i klorit 0,75% që Ju e prodhoni me rekomandimin e OE është i rrezikshëm sepse në sipërfaqen e epërme të Kontainerit krijohet sasi më e madhe se ajo e lejuar, lejohen vetëm koncentrimet deri me 0,60% (ose 600 mg/l) e jo më tepër. Ne jo që dyshojmë por jemi të sigurtë se çertifikatat e Analizës për të dy komponentet janë të falsifikuara, sepse OE ka ofertuar për Komponenten A dhe B kurse çertifikatat e Analizës e ka dërguar për Dioksidin e klorit 0,75%, e Oxide ClO₂-0,75%. Asnjë Laborant i kimisë e jo më një kimist i diplomuar ose docent nuk do të përpilonte një kesi lloj çertifikate të dobët. Vula në çertifikatë gjithashtu është e pa lexueshme dhe e manipuluar. Dhe për fund nuk dorezohet kurre dhe kurre çertifikata e Analizës për një Produkt që ende nuk është prodhuar dhe nuk është dërguar te pranuesi apo klienti.

Duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë kërkojmë nga AK që ta rishqyrton edhe një herë vendimin sepse është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), konkretisht e:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Pretendimi ynë është i bazuar në dëshmi dhe fakte të cilat lehtësisht mund të verifikohen, dëshmi të cilat i potencuam edhe më lartë, prandaj kërkojmë që NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES –B 58 i këtij tenderi të anulohet dhe të aprovohet kërkesa jonë për rivlerësim të tenderit, dhe pas një vlerësimi korrekt të shpallemi NE si fitues i tenderit në fjalë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni Kërkesën tonë për Rishqyrtim në mënyrë meritore dhe të nxjerrni këtë:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa e SAMET MESTANI B.I. të anulohet "Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues" për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht kërkojmë që të ktheni tenderin në rishqyrtimin dhe rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit sipas dispozitave të LPP-së dhe duke u bazuar në kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, duke na rekomanduar kompaninë tonë fituese pasi që supozojmë që jemi të kompletuar për këtë projekt

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojme që kemi bërë shpenzime materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, për përgatitjen e ankesës si dhe dëmtime tjera në fitimin e pritur, vlerë të referencave, imazh dhe dëmtime tjera që mund të ndodhin

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*